



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

KOMISIONI I ANKIMIT TË ISHPSHSH-SË

Nr. 2444/3 Prot.

Tiranë, më 23.12.2022

Lënda: Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së

SHOQËRISË : “ALEKSANDËR SOKOLI”, ME NIPT M02221017G

Adresa: Rruga e Kavajës, Square 21 Apartamenti nr.12 shkalla 4, Tiranë

Bazuar në pikën 2 të nenit 51 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimimit për vendimin përfundimtar Nr.ISHPSHSH-DQ-2022-000051-5, datë 26.10.2022, të subjektit “Aleksandër Sokoli”, Komisioni i Ankimit, i ngritur pranë ISHPSHSH-së, pasi shqyrtoi kërkesën tuaj ankimore për dy masat administrative kryesore “paralajmërim” për shkelje të VKM nr.101, datë 23.02.2018, pika 3 dhe pika 5 dhe për masën administrative plotësuese “gjobë” në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, si dhe në mbështetje të procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes së komisionit:

VENDOSI:

1. **Lënie në fuqi** të vendimit përfundimtar Nr.ISHPSHSH-DQ-2022-000051-5, datë 26.10.2022 duke lënë në fuqi dy masat administrative kryesore “paralajmërim” dhe dënimin administrativ plotësues “gjobë” në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë si dhe rrëzimin e ankimimit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas legjislacionit në fuqi.

KRYEINSPEKTOR

Eljo Muçaj